



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3666 Prot  
A

Himarë, më 22.05. 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 28, datë 22.05.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT MBI RADHËN E PUNËS DHE PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN NGA DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE NË BASHKINË HIMARË, STRUKTURAT E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI, DREJTORITË DHE SEKTORI I MZSH PRANË BASHKIVE, INSTITUCIONET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE NË RASTET E RËNIES SË ZJARREVE MASIVE NË PYJE DHE KULLOTA”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”;

Këshilli Bashkiak Himarë pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e veprimit mbi radhën e punës dhe procedurat që do të ndiqen nga drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile në bashkinë himarë, strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, drejtoritë dhe sektori i mzsh pranë bashkive, institucionet shtetërore përgjegjëse në rastet e rënies së zjarreve masive në pyje dhe kullota.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

## PLANI I VEPRIMIT

### “MBI RADHËN E PUNËS DHE PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN NGA DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE NË BASHKINË HIMARË, STRUKTURAT E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI, DREJTORITË DHE SEKTORI I MZSH PRANË BASHKIVE, INSTITUCIONET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE NË RASTET E RËNIES SË ZJARREVE MASIVE NË PYJE DHE KULLOTA”

#### BAZA LIGJORE

1. Ligji nr.45/2019, date 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”.
2. Ligj nr.152/2015, “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.
3. Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
4. V.K.M nr. 807, date 28.12.2023, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”.
5. VKM nr 168 datë 24.03.2023 “Vlerësimi i Riskut nga fatkeqësit natyrore”.
6. VKM nr.94 datë 22.02.2023, “Strategjia kombëtare e Vlerësimit të riskut”
7. V.K.M. nr 965, date 02.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave”.
8. Ligjit nr.57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”

#### QËLLIMI:

Marrja e masave paraprake për parandalimin dhe përballimin e shuarjes të zjarreve që mund të shkaktohen në objekte, në sipërfaqe të mëdha në pyje dhe kullota në gjithë territorin e Bashkisë Himarë, përgatitja dhe planifikimi i elementëve të gadishmërisë nga të gjitha strukturat pjesëmarrëse për organizimin e shuarjes të zjarreve, rritja e aftësive të drejtuesve për reagimin e menjëhershëm, si dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve me strukturat e tjera të bashkisë për përballimin e situatave të rënies të zjarreve në këto objekte me rëndësi ekonomike.

Për periudhën pranverë-verë 2026 si rezultat i rritjes ekstreme të temperaturave, dhe të krijimit të situatave emergjente nga zjarret masive në sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor në gjithë territorin e bashkisë, nga Sektori i M.C të Bashkisë Himarë, Drejtoritë/Sektorët e përfshira pranë bashkive, përgjegjësit e M.Z.SH-së pranë bashkisë. Drejtoria (Sektorët) e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë strukturat e tjera të institucioneve shtetërore përgjegjëse, për përballimin dhe menaxhimin e këtyre zjarreve ndjekin këtë radhë pune:

#### Rradha e punës për menaxhimin e situatës në rastë zjarri

- Me marrjen e informacionit nga burime të ndryshme për rënie zjarri, mbas konfirmimit të vërtetësisë së ngjarjes dhe saktësisë të vendit ku ka rënë zjarri, vihet në dijeni Kryetari i Bashkisë, Prefekti i Qarkut dhe Q.K.O.E.C (.A.K.M.C).

- Nga ana e Mzsh-së të vihet dijeni Kryetari i Bashkisë, Sektori i M.C, Administratori i NJ. Adm, drejtuesit e shërbimit pyjor. si dhe drejtuesit i Komisararit të Policisë, Posta e Policisë për Kufirin dhe Migracionin, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia e Zonave të Mbrojtura subjektet private të cilat kanë në administrim sipërfaqe kullotësore dhe pyje.
- Nga sektori i M.C, evidentohet situata e rënies së zjarrit dhe ndjekin në vazhdimësi masat e marra nga strukturat përgjegjëse të cilat e vënë në dijeni për veprimin konkret që ato kryejnë në terren në luftë kundër zjarrit.
- Merr informacione të vazhdueshme mbi forcat dhe mjetet pjesëmarrëse në vatrën e zjarrit, zhvillimin e situatës dhe marrjen e masave të mëtejshme për shtimin e mjeteve dhe forcave nga strukturat e tjera përgjegjëse.
- Ndjek zhvillimin e situatës për shuarjen e zjarrit ne terren deri në izolimin dhe shuarjen e tij përfundimtar dhe informon Kryetarin e Bashkisë, Prefektin dhe Q.K.O.E.C (.A.K.M.C)..
- Për rastet e rënies së zjarrit u kërkohet strukturave të Komisararit të Policisë informacion për zbulimin dhe identifikimin e zjarrvënësve.

**Kur rastet e zjarreve janë të mëdha dhe nuk arrin të përballohet nga forcat dhe mjetet e një bashkie veprohet në këtë mënyrë:**

Sektori i M.C i propozon Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e K.M.C.B. Bëhet njoftimi i anëtarëve të K.M.C.B dhe organizohet mbledhje e këtij komisioni. Bëhet njohja e anëtarëve të komisionit me situatën aktuale të krijuar.

Kryetari cakton drejtuesin e operacionit në shkallë Bashkie, (*Përgjegjësi i Sektorit të M.C dhe Përgjegjësi i sektorit të shërbimit të Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të bashkisë ku ka rënë zjarri të cilin e kompletton me forca dhe mjete të nevojshme.*)

Udhëzon anëtarët e komisionit për ndjekjen nga afër të situatës, dhe organizimin e punës në vendngjarje për shuarjen e zjarreve duke pasur prioritet jetën e njerëzve, gjënë e gjallë si dhe pronën private.

Kryetari mbledh të dhënat që dërgon sektori i M.C. së bashkisë dhe MZSH, i përpunon ato dhe i raporton Prefektit.

- Mbi bazën e informacioneve të marra dhe raportimeve nga sektori i M.C. së bashkisë dhe MZSH, harton raportin e dy orëve të para dhe i dërgon ato pranë Prefektit, Q.K.O.E.C (.A.K.M.C)..

Kur rënia e zjarrit ka një shtrirje të madhe dhe situata vështirësohet Kryetari i Bashkisë i bën kërkesë Prefektit dhe ky i fundit MM. për futjen në veprim të forcave të ushtrisë (*Detashmentin e Mbështetjes Rajonale*).

- Kur për shkak të terrenit kur nuk mund të veprojnë forcat dhe mjetet zjarrfikës dhe situata del jashtë kontrollit, Kryetari i Bashkisë i kërkon dhe Prefektit kërkon pranë Q.K.O.E.C (.A.K.M.C). duke bërë kërkesë me shkrim për ndërhyrje me forca shtesë (*nga toka ose ajri*).

Drejtuksi operacional në shkallë qarku drejton veprimet e forcave dhe të mjeteve duke pasur parasysh:

- Vazhdueshmërinë e drejtimit të veprimeve.
- Organizimin e luftimit me zjarrin.
- Organizimin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimin e forcave dhe mjeteve pjesëmarrëse.
- Furnizimin e vazhdueshëm me bazë materiale, mjete, pajisje dhe lëndë shuarëse.
- Vendosjen dhe mbajtjen në vazhdimësi të kontakteve, veçanërisht gjatë veprimeve në luftë kundër zjarrit.
- Bën informimin në mënyrë të vazhdueshme mbi situatën operationale Prefektit të Qarkut dhe Q.O.A.K.M.C.

**Procedurat që ndiqen nga sektori i Mbrojtjes Civile. në rastet e ndërhyrjeve me mjete ajrore të fikjes së zjarreve**

- Për rastet e zjarreve të cilat nuk mund të vihen nën kontroll nga forcat dhe mjetet zjarrfikës nga toka, zjarre të cilat dalin jashtë kontrollit dhe rrezikojnë objekte dhe sipërfaqe të mëdha me pyje, mbas vlerësimit të situatës aktuale nga strukturat vendore (bashkitë) i bëhet kërkesë Prefektit të Qarkut, i cili vendos për ndërhyrje me mjete Ajrore në konsult me Q.K.O.E.C (.A.K.M.C).
- Sektori i Mbrojtjes Civile. të Prefektit i bën fillimisht Q.K.O.E.C (.A.K.M.C), kërkesë me telefon për ndërhyrje nga ajri ku e orienton atë me vendin (*koordinatat*) e rënies së Zjarrit. Më pas kjo kërkesë dërgohet me e-mail e konfirmuar nga Prefekti.

Nga Sektori i Mbrojtjes Civile bëhet regjistrimi i kërkesës për ndërhyrje nga ajri në ditarin e ngjarjeve të ndodhura.

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHER**  
**ZEVENDESKRYETARI**

**Erifili Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3666/2 prot.

Himarë, më 22.05 . 2026

**Lënda:** Relacion për miratimin planit të masave dhe planit të veprimit, për emergjencat civile në bashkinë Himarë, për periudhën pranverë - verë 2026,

### KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË

#### KËTU

I nderuar Kryetar i Këshillit,  
të nderuar këshilltarë;

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, Bashkia Himarë duke kryer vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, ju informojmë si më poshtë:

Pyjet dhe kullotat në Bashkinë e Himarës, zënë një sipërfaqe prej rreth 40% të gjithë sipërfaqes totale të Bashkisë. Mos manazhimi i mirë i këtyre pasurive, ka bërë që gjatë sezonit pranverë-verë të vitit 2023-2024 dhe sidomos viti 2025, ka patur vatra dhe provokime zjarresh në shumë vende. Numri i zjarreve nga shkaqe natyrore është shumë i vogël. Rastet e zjarreve janë pothuajse nga dora e njeriut qoftë ato aksidentale ose me dashje.

Në Bashkinë Himarë, ka pasur raste të shumta zjarresh të qëllimshme për përfitimin e kullotave duke kërcënuar disa herë dhe spërfaqet që ndodhen në zona të mbrojtura me vlera kombëtare. Shpenzimet për fikjen e zjarreve nga toka ose me ndërhyrje nga ajri kanë qenë shumë të mëdha gjatë vitit 2025, kjo duke u nisur nga angazhimi kapaciteteve lokale dhe bashkive fqinje, i kapaciteteve FA me mjete efektiv dhe nga ajri ashtu dhe ato në kuadër të Mekanizmit European të Emergjencave.

Gjatë vitit 2025 zjarret kanë patur shtrirje pothuajse gjatë gjithë vitit. Zjarret kanë qenë në përgjithësi për djegie të mbetjeve në parcelat bujqësore ose në kullota. Zjarret janë shoqëruar me dëmtime në kullota, pyje, ullishte dhe dru.

Gadishmëria e mjeteve dhe personelit, marrja në kohë e sinjalit për zjarre dhe koordinimi, mbetet elementi kyç për fikjen shpejt të zjarreve dhe uljen e kostos për fikje.

Marrja e masave paraprake për parandalimin dhe përballimin e shuarjes të zjarreve që mund të shkaktohen në objekte, në sipërfaqe të mëdha në pyje dhe kullota në gjithë territorin e Bashkisë Himarë, përgatitja dhe planifikimi i elementëve të gadishmërisë nga të gjitha strukturat

pjesëmarrëse për organizimin e shuarjes të zjarreve, rritja e aftësive të drejtuesve për reagimin e menjëhershëm, si dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve me strukturat e tjera të bashkisë për përballimin e situatave të rënies të zjarreve në këto objekte me rëndësi ekonomike.

Për periudhën pranverë-verë 2026 si rezultat i rritjes ekstreme të temperaturave, dhe të krijimit të situatave emergjente nga zjarret masive në sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor në gjithë territorin e bashkisë, nga Sektori i M.C të Bashkisë Himarë, Drejtoritë/Sektorët e përfshira pranë bashkive, përgjegjësit e M.Z.SH-së pranë bashkisë. Drejtoria (**Sektorët**) e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë strukturat e tjera të institucioneve shtetërore përgjegjëse, për përballimin dhe menaxhimin e këtyre zjarreve ndjekin radhën e punës si në dokumentacionin e paraqitur në Planin e Veprimit “Mbi radhën e punës dhe procedurat që do të ndiqen nga drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile në bashkinë Himarë, strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, drejtoritë dhe sektori i mzsh pranë bashkive, institucionet shtetërore përgjegjëse në rastet e rënies së zjarreve masive në pyje dhe kullota”.

Duke qenë se ligjshmëria kërkon miratimin nga ana juaj, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e planit të masave dhe planit të veprimit, për emergjencat civile në bashkinë Himarë, për periudhën pranverë - verë 2026.

**DREJTOR**

**Ilia Gjika**

